

VËRTETIMI MBI DORËZIMIN E DOKUMENTIT

POTVRDA O DOSTAVI DOKUMENTA

ACKNOWLEDGEMENT OF RECEIPT OF A DOCUMENT

Duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, pala e nënshkruar më poshtë vërteton pranimin e dokumentit:

Në osnovu Zakona br. 04/L-033 o Specijalnoj komori Vrhovnog suda Kosova za pitanja koja se odnose na Kosovsku agenciju za privatizaciju, dole potpisana stranka potvrđuje dostavu dokumenta navedenog dole:

Pursuant to Law no-04/L-033 on Special Chamber of the Supreme Court of Kosovo on Privatization Agency of Kosovo Related Matters, the below signed party acknowledges receipt of the document described below:

Ndërmarrja: Preduzëçe: Enterprise:

Numëri i lëndës: Broj predmeta: Case Number:

Data e regjistrimit: Datum registrovanja: Date registered:

1. Trepça

Socially Owned Enterprise • Mining and Metallurgy-Chemical Combine

AC-I.-12-0131

12/02/2013

Paditës
Tužilac
Claimant

Përfaqësues
Punomočnik
Representative

I paditur
Tuženi
Respondent

Përfaqësues
Punomočnik
Representative

#	Titulli i Dokumentit:	Naziv dokumenta:	Document Name:	Datë Datum Dated
1	Aktvendim nga Dhoma	Rešenje komore	Decision of the Chamber	07/02/2013

1036
4726/2006
13 13.02.13

Pala: Stranka: Party: 1. Agjencia Kosovare e Privatizimit

Authority • Privatization • Ilir Konushevi 8, Prishtinë

Pranuar nga: Primio: Received by: _____

Titulli: Zvanje: Title: _____


Data: Datum: Date: _____

Nënshkrimi Potpis: Signature: _____

Në bazë të nenit 25.8 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033, të gjitha parashtrësit dhe dokumentet mbështetëse duhet të paraqiten ose në gjuhën shqipe ose në gjuhën serbe dhe të shoqërohen edhe me përkthimin në gjuhën anelete.

Na osnovu člana 25.8 Dodatka Zakona br. 04/L-033, svi podnesci i prateći dokumenti moraju da budu podneseni na albanskom ili srpskom jeziku zajedno s prevodom na engleski jezik.

Pursuant to Section 25.8 of the Annex of the Law no 04/L-033, all pleadings and supporting documents must be submitted either in Albanian or in Serbian accompanied by an English translation.



për shkrimorën - za pisarnicu - for registry

DHOMA E POSAÇME E SPECIAL CHAMBER OF THE POSEBNA KOMORA
GJYKATËS SUPREME TË SUPREME COURT OF VRHOVNOG SUDA
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË KOSOVO ON KOSOVA ZA PITANJA
LIDHEN ME AGJENCINË PRIVATISATION AGENCY KOJA SE ODOSE NA
KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT OF KOSOVO RELATED KOSOVSKU AGENCIJU
MATTERS ZA PRIVATIZACIJU

AC-I.-12-0131

Në çështjen juridike të:

Agjencisë Kosovare të Privatizimit-AKP-së

Parashtrues i ankesës

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, si gjyqtar kryesues, Merja Halme-Korhonen, Alfred Keyserlingk, Sabri Halili dhe Esmat Erterzi, gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së AKP-së të parashtruar kundër Aktvendimit të Kolegjit të Specializuar C-V-12-0003, të datës 08 nëntor 2012, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 7 shkurt 2013 morri këtë:

AKTVENDIM

1. Ankesa e AKP-së është e bazuar.
2. Anulohet Aktvendimi i Kolegjit të Specializuar C-V-12-0003, i datës 08 nëntor 2012.
3. Lejohet vazhdimi i afatit për "publikimin e Njoftimit për Afatin e Kërkesave" deri me 1 nëntor 2013.
4. Nuk caktohen shpenzimet gjyqësore në këtë procedurë ankimore.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 19 tetor 2012, ankuesi ka parashtruar kërkesë në DHPGJS për vazhdimin e „Afatit për publikimin e Njoftimit për Afatin e Kërkesave “. Sipas arsytimit të kësaj kërkesë, më 9 mars 2006 DHPGJS-ja ka lëshuar Vendimin për Moratorium (SCR-05-001) për

Riorganizimin e Ndërmarrjes Shoqërore „Trepça“ në përputhje me dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2005/48. Ky vendim ishte marrë sipas kërkesës së ish-AKM-së. Agjencia ka bërë publikimin e këtij vendimi, konform ligjit në mediat vendore e ndërkombëtare në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

AKP jep disa argumentin tjera për këtë kërkesë: a) se zgjatja e këtij afati që do të miratohej nga gjykata është në interesin e përgjithshëm të ndërmarrjes dhe në përputhje me mandatin ligjor të AKP-së, për të ruajtur dhe rritur vlerën dhe suksesin e ndërmarrjes.

b) Pas publikimit të njoftimit të Moratoriumit, mandati i Bordit të Drejtorëve të Agjencisë ka skaduar dhe aktualisht AKP funksionon në mungesë të organit kryesor vendimmarrës.

Mu për këtë dhe arsye tjera, AKP kërkon miratimin e kërkesës për vazhdimin e afatit për publikimin e Njoftimit për Afatin e Kërkesave, duke propozuar datën 1 nëntor 2013 si datë të skadimit të afatit të vazhduar. Deri në këtë kohë, AKP-ja parasheh se do të themelohet dhe funksionalizohet Bordi i Drejtorëve i AKP-së, si një organ ekzekutiv-vendimmarrës dhe se pas kësaj AKP do të mund të veproj në mbrojtjen e interesave të pronarëve dhe kreditorëve të ndërmarrjes dhe të përmbush kërkesat e parapara sipas nenit 21 dhe 22 të Ligjit mbi Riorganizimin.

Më 08 nëntor 2012, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së ka marrë Aktvendimin C-V-12-0003, me të cilin hedhet kërkesa e AKP-së për vazhdimin e afatit për shtyrjen e publikimit të „Afatit të parashtrimit të kërkesave“ si e papranueshme.

Në arsyetimin e Kolegjit të Specializuar thuhet se sipas nenit 17 paragrafi 1 i Ligjit për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara, thuhet se *„jo më vonë se 360 ditë pas publikimit të parë të njoftimit të moratoriumit në mënyrën e specifikuar me dispozitat e njoftimeve administratori do të publikoj një tjetër njoftim të quajtur „njoftimi për afatin e kërkesave“.*

Sipas Kolegjit të Specializuar, meqenëse njoftimi i parë është bërë më 08 nëntor 2011, deri në kohën e dorëzimit afati prej 360 ditësh nuk ka kaluar, që do të thotë se AKP ka bërë kërkesë të parakohshme. Kolegji i Specializuar ka konsideruar se kjo kërkesë tani është kërkesë jolëndore, se AKP tashmë e ka bërë shpalljen e njoftimit për të cilën ka

kërkuar vazhdimin e afatit dhe se gjykata nuk ka interes ligjor të merret më me këtë çështje pasi që nuk ka objekt shqyrtimi.

Më 31 nëntor 2012, AKP ka parashtruar ankesë në DHPGJS duke e kundërshtuar në tërësi Aktvendimin e ankimuar, sepse sipas saj, është bërë zbatim i gabuar i dispozitave ligjore dhe vërtetim jo i plotë dhe i gabuar i gjendjes faktike.

AKP kërkon që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet aktvendimi i ankimuar dhe të aprovohet kërkesa e saj për vazhdimin e afatit të cekur, sepse kërkesa është bërë në kuadër të afatit dhe të kushteve ligjore.

Arsyvetimi Ligjor

Ankesa është e pranueshme dhe e bazuar.

Konform nenit 64.1 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/033 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (më tej: Shtojca), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Pranueshmëria e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Në ankesën e saj, AKP thekson se Kolegji i Specializuar ka bërë në mënyrë të gabuar zbatimin e të drejtës materiale lidhur me publikimin nga Agjencia të, "Njoftimit për afatin e kërkesave", më 1 nëntor 2012. Sipas nenit 42.1 të Ligjit për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së tyre (Ligji mbi Riorganizimin) parashihet që, „në çdo moment gjatë procedurës së riorganizimit, Administratori, apo ndonjë kreditor i kualifikuar, mund t'ia parashtror kërkesë me shkrim Gjykatës, duke kërkuar udhëzim lidhur me ndonjë çështje lidhur me... përputhshmërinë me këtë ligj apo Planin e Konfirmuar të Riorganizimit“. Sipas AKP-së, kjo dispozitë i mundëson gjykatës që gjatë marrjes së vendimit të marrë parasysh arsyeshmërinë, nevojën dhe/apo përshtatshmërinë e mënyrës së propozuar të veprimit.

Ndërkaq, sipas nenit 42. 4, „Gjykata mund të vazhdojë cilindo afat të caktuar sipas dispozitave ligjore, përpos nëse dispozitat ligjore parashohin ndonjë kufizim specifik të autoritetit të Gjykatës për të vazhduar afatin në fjalë“. Kjo dispozitë, sipas AKP-së duhet

të interpretuar të ndërlidhur edhe me nenin 42 paragrafi 3 i këtij ligji, që i mundëson gjykatës që në çdo kohë gjatë procesit të riorganizimit, nëse përcaktohet si e nevojshme, e arsyeshme apo e duhur, të zgjas secilin afat të parashikuar sipas Ligjit për Riorganizimin.

Ndërkaq, neni 17, paragrafi 1 i këtij Ligji e obligon AKP-në që të publikoj „Njoftimin për afatin e Kërkesave" jo më vonë se 360 ditë pasi që njoftimi i moratoriumit të jetë publikuar për herë të parë. Konform kësaj kërkesë Agjencia e ka bërë këtë njoftim, konsideron AKP dhe thekson se publikimi i këtij njoftimi nuk është në kundërshtim me kërkesën e AKP-së për shtyrje të afatit të tillë, por pikërisht konform kërkesës ligjore.

Pas analizimit të pretendimeve ankimore dhe aktvendimit të kundërshtuar, Kolegji i Apelit ka gjetur se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar dhe se duhet të anulohet aktvendimi i ankimuar, për shkak se nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor.

Arsyetimi i Kolegjit të Specializuar se, *„kërkesa e AKP-së është jolëndore dhe nuk ka se çka të shqyrtohet“*, nuk ka mbështetje ligjore, sepse neni 42.4 thotë se, *„Gjykata mund të vazhdojë cillindo afat të caktuar sipas dispozitave ligjore, përpos nëse dispozitat ligjore parashohin ndonjë kufizim specifik të autoritetit të Gjykatës për të vazhduar afatin në fjalë“*, e kjo ndërlidhet edhe me dispozitën e nenit 42.3 të Ligjit mbi Riorganizimin i cili thotë se, *„Gjykata mund të nxjerr urdhër, proces, apo aktgjykim që është i arsyeshëm, i nevojshëm, apo i duhur për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, apo për të avancuar riorganizimin apo likuidimin e ndërmarrjes“*. Meqenëse kjo Ndërmarrje Shoqërore është në një fazë delikate dhe ende nuk është kryer riorganizimi dhe regjistrimi i detajuar i aseteve, gjykata duhej ta kishte parasysh nëse në këtë gjendje kjo ndërmarrje do të ketë mundësi t'i përmbushë kërkesat kreditore në mënyrë kreative, kualitative dhe të plota. Andaj, aktvendimi i kundërshtuar duhet të anulohet.

Sa i përket zgjidhjes që ofron ligji lidhur me këtë çështje, këtu gjykata nuk ka pasur asnjë arsye që ta hedhë poshtë si të papranueshme kërkesën e AKP-së, sepse AKP ka bërë njoftimin para se të skadojë afati i paraparë ligjor, në mënyrë që të mos e humb afatin brenda të cilit ligji kërkon që ky njoftim të bëhet. AKP ka bërë gjithashtu konform ligjit, edhe kërkesë në gjykatë, që edhe zyrtarisht të lejohet vazhdimi i afatit. Pra, në kohën

kur është shqyrtuar kjo kërkesë nga gjykata, ky afat prej 360 ditësh tashmë kishte arritur, andaj nuk ka pasur "kërkesë jolëndore", siç ka konstatuar pa të drejtë Kolegji i Specializuar.

Andaj Aktvendimi i Kolegjit të Specializuar C-V-12-0003, të datës 08 nëntor 2012, anulohet dhe konform nenit 42 paragrafi 4, lidhur me paragrafin 3 të Ligjit për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe të Pasurisë së Tyre, i lejohet AKP-së vazhdimi i afatit për "Afatin e parashtrimit të kërkesave", për periudhën siç është kërkuar për 12 muaj, përkatësisht deri më 1 nëntor 2013

Kolegji i Ankesave kërkon nga AKP që në afatin sa më të arsyeshëm, të ndërmarr këto hapa:

- a) Në përputhje me dispozitat e nenit 43 të Ligjit për Riorganizimin do të publikoj një shkresë zyrtare për të bërë publike këtë zgjatje
- b) T'u dërgoj njoftimet individuale të gjithë kreditorëve të cilët tashmë i kanë parashtruar kërkesat e tyre, apo atyre që do të parashtrojnë kërkesat e tyre gjatë afatit aktual për paraqitjen e ankesave, për t'i njoftuar ata për këtë zgjatje.
- c) Të përfshij formulimin në njoftim se „të gjithë kreditorët që kanë parashtruar kërkesat e tyre më herët, se kërkesat e tyre do të konsiderohen si kërkesa të parashtruara me kohë, dhe se ata mund t'i plotësojnë kërkesat e mëhershme“.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 10.10 të Ligjit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 04/L-033, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Shpenzimet/taksa gjyqësore:

Gjykata nuk i cakton taksat gjyqësore, meqë Presidiumi i gjykatës deri tani nuk e ka nxjerrë një dokument me shkrim që do të miratohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. (neni 57 paragrafi 2 i LDHPGJS-së). Kjo do të thotë se tani për tani nuk ekziston bazë e mjaftueshme ligjore për të vënë taksa gjyqësore.

Ka vendosur Kolegji i Ankesave të DHPGJS më 7 shkurt 2013

Mr.sc.Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues

